Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar

INSP/106658-XK

RAPORT DHE REKOMANDIM NGA MENAXHMENTI

NË PËRGJIGJE TË

RAPORTIT TË HETIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS

PROJEKTI ENERGJETIK I KOSOVËS (I PROPOZUAR, P118287) DHE FINANCIMI I DYTË SHTESË PËR PROJEKTIN PËR PASTRIM TË SEKTORIT TË ENERGJISË DHE BONIFIKIM TË TOKËS (P131539)

18 TETOR 2016

RAPORT DHE REKOMANDIM NGA MENAXHMENTI
NË PËRGJIGJE TË RAPORTIT TË HETIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS
PROJEKTI ENERGJETIK I KOSOVËS (I PROPOZUAR, P118287) DHE FINANCIMI I DYTË SHTESË PËR PROJEKTIN PËR PASTRIM TË SEKTORIT TË ENERGJISË DHE BONIFIKIM TË TOKËS (P131539)

Në pajtim me paragrafin 23 të Rezolutës për Krijimin e Panelit të Inspektimit (IBRD Rezoluta 93-10 dhe IDA Rezoluta 93-6), bashkangjitur për shqyrtim nga Drejtorët Ekzekutivë është Raporti dhe Rekomandimi i Menaxhmentit në përgjigje të gjetjeve të parashtruara në Raportin e Hetimit nr. 106658 datë-XK të datës 12 shtator 2016, të Panelit të Inspektimit për Projektin me emërtimin: Republika e Kosovës: Projekti Energjetik i Kosovës (i propozuar, P118287) dhe Financimi i dytë shtesë për Projektin e pastrimit të sektorit të energjisë dhe bonifikim të tokës (P131539)

Ky dokument është përkthim i cili është ofruar si shërbim për palët e interesuara. Nëse ndonjë pjesë e tekstit të dokumentit origjinal në anglisht është në kundërshtim me tekstin e këtij përkthimi, dokumenti origjinal në gjuhën angleze ka përparësi.

RAPORT DHE REKOMANDIM NGA MENAXHMENTI NË PËRGJIGJE TË RAPORTIT TË HETIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT NR. 106658-XK

REPUBLIKA E KOSOVËS PROJEKTI ENERGJETIK I KOSOVËS (I PROPOZUAR, P118287) DHE FINANCIMI I DYTË SHTESË PËR PROJEKTIN PËR PASTRIM TË SEKTORIT TË ENERGJISË DHE BONIFIKIM TË TOKËS (P131539)

PËRMBAJTJA

Shkurtesat dhe akronimet iii
Përmbledhje Ekzekutive iv
I. Hyrje 1
II. Sfondi i Projekteve 1
III. Konteksti në lidhje me Vendin dhe Sektorin 7
IV. Përgjigja nga Menaxhmenti 9
V. Përgjigjet për Vrojtimet e Panelit 12
VI. Plani i Veprimit i Menaxhmentit në përgjigje të gjetjeve 14
VII. Konkluzioni 16

Shtojcat:

Shtojca 1. Gjetjet, komentet dhe veprimet
Shtojca 2. Gjetjet e Panelit

Hartat:

Harta 1. Vendndodhja e fushave të mihjes, termocentralet, fshatrat e prekura dhe Zona me Interes të Veçantë Ekonomik

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

BP	Procedurat e Bankës
CCS	Kapja dhe sekuestrimi i karbonit
CLRP	Projekti për pastrim dhe bonifikim të tokës
CLRP-AF	CLRP Financimi shtesë
CLRP-SAF	CLRP Financimi i dytë shtesë
VNMS	Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social
BE	Bashkimi Evropian
QK	Qeveria e Kosovës
IDA	Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar
IED	Direktiva për emisione industriale
IPN	Paneli inspektues
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
PEK	Projekti Energjetik i Kosovës
TCKR	Termocentrali Kosova e Re
PATEL	Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti
MMPH	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor
OP	Politika Operacionale
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
GPRR	Garancia e pjesshme e rrezikut
PVZH	Plani i veprimit për zhvendosje
KPZH	Korniza e politikave të zhvendosjes
SDR	Të drejtat e veçanta për tërheqje
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

i. Ky Raport dhe Rekomandim i Menaxhmentit është përgatitur në përgjigje të hetimit të Panelit të Inspektimit pas Kërkesës për Inspektim në Republikën e Kosovë në lidhje me: Projektin Energjetik të Kosovës (të propozuar) dhe financimin e dytë shtesë për Projektin për pastrim të sektorit të energjisë dhe bonifikim të tokës (CLRP-SAF), financuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA, ose "Banka").

ii. **Menaxhimi pajtohet me gjetjet e Panelit që Banka nuk ishte përgjegjëse për dëmin që rrjedh qoftë nga evakuimi emergjent i vitit 2004/2005 kryer nga UNMIK-u, apo nga ndikimet negative që lidhen me kufizimet që rrjedhin nga Zona me Interes të Veçantë Ekonomik. Menaxhimi vëren se asnjë nga zhvendosjet e cituara në Kërkesë ose në Raportin e Panelit nuk rezultojnë nga një projekt i mbështetur nga Banka, por nga aktivitetet e vazhdueshme xehetare në Kosovë.**

iii. **Më tej, Paneli ka gjetur se qasja e Bankës për përgatitjen e një KPZH dhe PVZH për Shalën është në përputhje me OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare. Ai gjithashtu gjeti se Banka ishte në përputhje me OP/BP 4.12 në lidhje me monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit të zhvendosjes sipas CLRP-SAF.**

iv. **Paneli ka gjetur dy raste të mosrespektimit të OP/BP 4.12 që kanë të bëjnë me përgatitjen e KPZH dhe PVZH për Shalën. Sipas pikëpamjes së Menaxhmentit të dyja raste nuk kanë ndikime të rëndësishme, dhe janë duke u propozuar veprimet e Menaxhmentit për adresimin e tyre.**

Sfondi

v. Kërkesa ka të bëjë me pretendimet e dëmit që rezultoi nga rivendosja e ndërlidhur me veprimtarinë xehetare në Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik në Kosovë, si dhe nga një evakuim emergjent të mëhershëm nga fshati Hade. Kërkesa gjithashtu lidh dëmin e pretenduar të aktiviteteve nën projektet e Bankës për ndihmesë teknike dhe përgatitjen e Projektit Energjetik të Kosovës, të propozuar (PEK).

vi. Mbështetja e Bankës përfshinte përgatitjen e Kornizës së Politikës për Zhvendosje (KPZH) për Fushën e Re të Mihjes, dhe Planin e Veprimit për Zhvendosje për lagjen Shala të fshatit Hade (PVZH për Shalën). Pas një kërkese nga Qeveria e Kosovës, Banka gjithashtu ka mbështetur monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit të zhvendosjes së Shalës.

vii. Në lidhje me Projektin Energjetik të Kosovës (PEK) të propozuar, Qeveria ka përgatitur një draft Vlerësim të Ndikimit Mjedisor dhe Social për PEK të propozuar, me financim të Bankës. Ky draft VNMS është një pjesë e rëndësishme e kujdesit të duhur të Bankës për të informuar një vendim eventual për PEK të propozuar. Megjithatë, kjo nuk është VNMS përfundimtar për projektin e propozuar. Për më tepër, Qeveria dhe investitori privat janë duke diskutuar ndryshime të rëndësishme në konfigurimin e projektit të propozuar, i cili, nëse miratohet, do të kërkojë që draft VNMS të rishikohet dhe të përditësohet në mënyrë të konsiderueshme. Prandaj, draft VNMS ende nuk është shpalosur apo konsultuar publikisht.

viii. Menaxhmenti vëren se Banka nuk ka bërë asnjë vendim për të mbështetur ose jo PEK të propozuar. Nëse e bën këtë, të gjitha ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale që rrjedhin nga projekti i propozuar do të duhet të vlerësohen dhe të zbuten në përputhje me Politikën e Bankës. Menaxhimi vëren se asnjë nga zhvendosjet e cituara në Kërkesë ose në raportin e Panelit nuk rezultojnë nga një projekt i mbështetur nga Banka, por nga aktivitetet e vazhdueshme xehetare në Kosovë.

Përgjigja nga menaxhmenti

ix. Menaxhmenti mirëpret shqyrtimin e tërësishëm nga Paneli dhe pajtohet me gjetjet e tij se Banka nuk është përgjegjëse për ndikimet që rrjedhin nga Zona me Interes të Veçantë Ekonomik dhe nga evakuimi emergjent i fshatit Hade në vitin 2004/2005. Menaxhmenti gjithashtu merr parasysh konstatimet e Panelit rreth pajtueshmërisë me OP/BP 4.12.

x. *KPZH.* Menaxhimin e pranon se ka disa dobësi në KPZH që duhet të adresohen për zhvendosjet në të ardhmen që ndërlidhen me veprimtarinë xehetare në Kosovë. Është e vërtetë se KPZH nuk përmban metoda të veçanta për vlerësimin e aseteve të prekura nga kufizimet në Zonë, por, KPZH kërkon zbatimin e parimit të vlerës së zëvendësimit, sipas OP/BP 4.12.

xi. *PVZH për Shalën.* Menaxhmenti gjithashtu pranon mangësitë në zbatimin e PVZH të Shalës, në veçanti vonesat në ndërtimin e infrastrukturës në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri dhe riparimin e pakryer të një pjese prej 200 metrash të linjës kryesore të kanalizimit në lokacionin e zhvendosjes.

Plani i veprimit

xii. *KPZH.* Banka do të ofrojë këshilla teknike për Qeverinë e Kosovës për rishikimin e KPZH me qëllim që të sigurohet konsistenca e saj e plotë me OP 4.12. Këshillat do të reflektojnë rekomandimet nga punëtoria e ekspertëve ndërkombëtar të zhvendosjes nga maji i vitit 2014, Raporti i Realizimit për PVZH të Shalës, dhe draft VNMS për PEK të propozuar. Për të siguruar udhëzime shtesë për QK në lidhje me rishikimin e KPZH, do të organizohet një punëtori me hisetarët kryesorë qeveritarë dhe KEK për t'i diskutuar këto rekomandime në mënyrë më të detajuar, deri më 27 shkurt 2017.

xiii. *PVZH për Shalën.* Qeveria ka nënshkruar një kontratë për të riparuar një pjesë të linjës së kanalizimit prej 200 metrash në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri dhe punimet pritet të përfundojnë deri më 31 dhjetor 2016. Banka do të vazhdojë të mbikëqyrë zbatimin e këtyre punimeve, edhe pse CLRP-SAF u përmbyll më 31 gusht 2016.

I. HYRJE

1. Më 30 qershor 2015, Paneli i Inspektimit regjistroi një Kërkesë për Inspektim, IPN Request RQ15/4 (këtej e tutje referuar si "Kërkesa"), në Republikën e Kosovës në lidhje me: Projektin Energjetik të Kosovës (të propozuar, P118287) dhe financimin e dytë shtesë për Projektin për pastrim të sektorit të energjisë dhe bonifikim të tokës (P131539), financuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA, ose "Banka"). Kërkesa u parashtrua nga qytetarët që përfaqësojnë fshatrat Shkabaj dhe Hade, si dhe Komunën e Obiliqit dhe nga tri organizata të shoqërisë civile me seli në Kosovë - Iniciativa për Mjedis dhe Zhvillim Lokal, Forumi për iniciativë qytetare (FIQ), dhe Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (tash e tutje "Kërkuesit").

2. Drejtorët Ekzekutivë dhe Presidenti i IDA u njoftuan nga Paneli për marrjen e Kërkesës. Menaxhmenti iu përgjigj pretendimeve në Kërkesë më 27 korrik 2015.

3. Në raportin e tij për Bordin, Paneli gjeti që Kërkesa ishte me vend dhe rekomandoi që Drejtorët Ekzekutivë të autorizojnë një hetim. Hetimi u autorizua nga Drejtorët Ekzekutivë më 17 shtator 2015.

4. Më 12 shtator 2016, Paneli lëshoi raportin e tij ku përvijohen rezultatet e hetimit. Menaxhmenti vlerëson paraqitjen e qartë dhe të tërësishme të gjetjeve nga ana e Panelit. Ky raport, në përgjigje të gjetjeve të Panelit, është i organizuar në disa pjesë. Pjesa II dhe III japin sfondin për projektet dhe kontekstin e vendit dhe sektorit, përkatësisht. Pjesa IV paraqet gjetjet e Panelit, ndërsa Pjesa V jep Përgjigjen e Menaxhmentit. Pjesa VI paraqet përgjigjet për vrojtimet e Panelit. Pjesa VII përmban Planin e Veprimit të Menaxhmentit në përgjigje të gjetjeve të Panelit, dhe Pjesa VIII përmbyll Raportin. Gjetjet e Panelit, së bashku me përgjigjet e Menaxhmentit, janë përshkruar në detaje në Shtojcën 1.

II. SFONDI I PROJEKTEVE

A. Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL)

5. ***Gjersa PATEL nuk i është nënshtruar hetimit nga Paneli, ai ka financuar aktivitetet që lidhen me Kërkesën për Inspektim.*** PATEL u miratua nga Bordi i Bankës më 12 tetor 2006, me një shumë totale prej SDR 5.8 milionë (shuma ekuivalente në US$ 8.1 milionë). Financimi shtesë për PATEL u miratua nga Bordi i Bankës më 28 qershor 2007, me një shumë totale prej SDR 1.4 milionë (shuma ekuivalente në US$ 2 milionë). Ai u përmbyll më 31 dhjetor 2011.

6. PATEL pati këto objektiva: (i) për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës (QK) në forcimin e kornizave të politikave, ligjore dhe rregullatore të favorshme që mundësojnë investime të reja në sektorin e energjisë; dhe (ii) për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës në tërheqjen e investitorëve të kualifikuar privatë për zhvillimin e minierave të linjitit dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë termike të linjitit, udhëhequr nga standarde të larta të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale.

7. ***Korniza e Politikave së Zhvendosjes.*** PATEL ka financuar përgatitjen e një Kornize të Politikave të Zhvendosjes (KPZH) për zhvendosjen jovullnetare në Fushën e Re të Mihjes (ose Zona e Interesit të Veçantë Ekonomik, siç përcaktohet me vendim të Qeverisë në vitin 2009). Fusha e Re e Mihjes është një zonë e madhe për mihjen e linjitit që përfshin Mihjen e Sibovcit Jug-Perëndim. KPZH u zhvillua nën PATEL si pjesë e mbështetjes së dhënë nga Banka për ngritjen e kapaciteteve në Kosovë. Zhvillimi i KPZH ka përfshirë konsultime të gjera me komunitetet lokale dhe hisetarët kryesorë. PATEL në vetvete nuk ka kërkuar ose rezultuar me ndonjë zhvendosje.

8. KPZH përcakton politikat e Qeverisë në lidhje me zhvendosjen e popullatës që do të shpërngulet për shkak të zhvillimit të infrastrukturës dhe aktiviteteve madhore xehetare që kërkojnë blerjen apo shpronësimin e pronës së paluajtshme. KPZH u miratua nga Qeveria e Kosovës me Vendimin 10/22 të Kryeministrit të Kosovës më 6 korrik 2011.

9. ***PVZH për Shalën.*** Përgatitja e Planit të Veprimit për Zhvendosje për lagjen Shala të fshatit Hade (PVZH për Shalën) gjithashtu u financua si një output i asistencës teknike në bazë të PATEL. PVZH për Shalën ka trajtuar zhvendosjen fizike të 63 familjeve dhe blerjen e tokës nga 30 titullarë jobanorë. Kjo zhvendosje ka rezultuar nga nxjerrja e linjitit e nevojshme për prodhimin e vazhdueshëm të energjisë elektrike në termocentralet Kosova A dhe B. Ajo nuk ka rezultuar nga ndonjë projekt ekzistues i financuar nga Banka. Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e PVZH të Shalës. Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës, Banka ka siguruar financim nëpërmjet një projekti tjetër (shih paragrafin 12 dhe 13 më poshtë) për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të PZH Shala.

10. Menaxhimi dëshiron të theksojë edhe një herë se zhvendosjet e cituara në Kërkesë ose të përmendura më lart kanë rezultuar nga aktivitetet e vazhdueshme xehetare të Qeverisë në Kosovë, dhe jo nga operacionet e mbështetura nga Banka.

B. Projekti për pastrim dhe bonifikim të tokës dhe financimi shtesë (i parë dhe i dytë)

11. Verzioni fillestar i ***Projektit për pastrim dhe bonifikim të tokës (CLRP)*** u miratua nga Bordi i Bankës më 13 qershor 2006, me një shumë totale prej SDR 3.8 milionë (shuma ekuivalente në US$ 5.3 milionë). ***Financimi i parë shtesë*** (CLRP-AF) u miratua nga Bordi i Bankës më 28 qershor 2007 me një shumë totale prej SDR 3.3 milionë (shuma ekuivalente në US$ 4.6 milionë). Projekti pati këto objektiva: (i) të trajtojë çështjet e trashëguara mjedisore që lidhen me hedhjen e hapur të hirit në tokë nga Termocentrali Kosova A që i takon Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK); (ii) t'ia mundësojë KEK që tokën që aktualisht është e mbuluar me materiale të djerrinës të vëjë në dispozicion për qëllime të zhvillimit komunitar dhe të rehabilitojë deponinë e hirit të Kosovës A;[1] dhe (iii) të inicojë ndryshime strukturore në KEK operacione të vazhdueshme të pastrimit dhe praktika të mira mjedisore në veprimtarinë xehetare. CLRP dhe CLRP-AF u përmbyllën më 30 qershor 2015.

[1] Deponia e hirit e Kosovës A përmban hirin nga Termocentrali Kosova A; deponia është stabilizuar, riformësuar, dhe mbuluar nën CLRP dhe financimin përkatës shtesë për të zbutur ndikimet e saj mjedisore.

12. ***Financimi i dytë shtesë (CLRP-SAF)*** u miratua nga Bordi i Bankës më 10 maj 2013 me një shumë totale prej SDR 2.8 milionë (shuma ekuivalente në US$ 3.9 milionë). CLRP-SAF u përmbyll më 31 gusht 2016.

13. CLRP-SAF ka shtuar ngritjen e kapaciteteve për praktikat e mira mjedisore në sektorin e xehetarisë dhe energjisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe për këtë arsye ka zgjeruar pikën e tretë të objektivave të zhvillimit të projektit për *"mbështetje të KEK dhe MMPH për zbatimin e operacioneve të pastrimit të vazhdueshëm dhe praktikat e mira mjedisore në sektorin e xehetarisë dhe energjisë."*

14. CLRP dhe dy financimet e saj shtesë kanë arritur rezultate të rëndësishme mjedisore, duke përfshirë eliminimin e hedhjes së hirit të thatë dhe pothuajse rehabilitimin e plotë të deponisë së hirit të Kosovës A. Përveç kësaj, 650 hektarë tokë janë bonifikuar për habitate natyrore, bujqësi apo qëllime të tjera të përdorimit të tokës në zonat e djerrinës së KEK-ut, si dhe 20,000 ton të substancave të rrezikshme nga gazifikimi i qymyrit janë hequr dhe trajtuar ë mënyrë të sigurt. Në fund, tri stacione për monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së ajrit janë instaluar në këtë zonë, me informacione të cilësisë së ajrit të vëna në dispozicion të publikut.[2]

C. Projekti Energjetik i Kosovës (PEK) i propozuar

15. PEK i propozuar do të mbështesë ndërtimin e një termocentrali të ri me linjit, Termocentrali Kosova e Re, i cili do të përdorë teknikat më të mira në dispozicion[3] për të përmbushur kërkesat rigoroze nga Direktiva për Emisionet Industriale (IED) e Bashkimit Evropian (BE).[4] Banka aktualisht është duke marrë parasysh mbështetjen e saj për PEK të propozuar përmes Garancisë së Pjesshme të Rrezikut (GPRR).

16. ***PEK i propozuar*** ka për qëllim të sigurojë: (i) furnizim të besueshëm me energji për ekonominë e Kosovës; (ii) përballueshmëri të energjisë për qytetarët dhe bizneset; dhe (iii) reduktim të konsiderueshëm të ndikimeve mjedisore dhe sociale nga prodhimi i energjisë elektrike.

17. ***Statusi i përgatitjes së PEK.*** Banka nuk ka marrë asnjë vendim nëse do të pranojë ose jo të vazhdojë me një GPRR për PEK të propozuar. Në qoftë se Banka vendos për të siguruar një GPRR për PEK të propozuar, të gjitha ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale që rrjedhin nga TCKR dhe mihja që do të furnizojë TCKR do të duhet të vlerësohen dhe të zbuten, në mënyrë të pranueshme për Bankën dhe në përputhje me politikat e aplikueshme mbrojtëse të Bankës. Banka do të marrë vendim vetëm pasi të gjitha analizat përkatëse mjedisore, sociale dhe teknike të jenë kryer; dhe të jenë mbajtur konsultimet publike.

---

[2] Rezultatet e tij janë dokumentuar, ndër të tjera në rrëfimet e mëposhtme të suksesit: http://www.worldbank.org/en/results/2012/10/06/cleaning-ash-and-chemical-waste-in-kosovo. Drejtori i zyrës vendore të Bankës Botërore foli në ngjarjen e inaugurimit për sistemin e ri të transportit të lagësht të hirit që shënoi fundin e praktikës 50-vjeçare të hedhjes së pakontrolluar të hirit të thatë: http://www.worldbank.org/en/news/feature/2014/03/10/kosovo-open-ash-dumping-practice-ends

[3] "Teknikat" përfshijnë si teknologjinë e përdorur ashtu edhe mënyrën në të cilën është dizajnuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar instalimi; (Direktiva e BE-së për Emisionet Industriale).

[4] Direktiva 2010/75/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 nëntor 2010 për emisionet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes), OJ L 334, 17.12.2010 (IED).

Draft VNMS për PEK

18. ***Draft VNMS për PEK (financuar nga CLRP-SAF).*** Siç thuhet në përgjigjen nga Menaxhmenti në Kërkesën për inspektim nga data 27 korrik 2015, Qeveria e Kosovës, përmes MMPH, ka përgatitur një draft VNMS për PEK të propozuar, me financim nga CLRP-SAF,[5] me qëllim të informimit të procesit të vendim-marrjes dhe për të rritur kapacitetet e monitorimit dhe menaxhimit të MMPH. Draft VNMS gjithashtu ka analizuar lokacionet e ndryshme për mihje që mund të furnizojnë TCKR.

19. ***Draft VNMS identifikon rreziqet mjedisore dhe sociale, ndikimet dhe mundësitë në lidhje me ndërtimin dhe funksionimin e TCKR 2x300MW dhe jep rekomandime të gjera për masat zbutëse.*** Rekomandimet për masat zbutëse për termocentralin u bazuan në kërkesat e IED dhe zbatimin e dokumentit të referencës për teknikat më të mira në dispozicion për impiantet e mëdha me djegie[6] si dhe udhëzimet mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë për termocentrale të Grupit të Bankës Botërore. Draft VNMS konsideron edhe infrastrukturën tjetër lidhur me TCKR, veçanërisht opsionet për mihje që mund të bëjnë furnizim me linjit të termocentralit dhe elementet përkatëse të kanalit Ibër-Lepenc, i cili furnizon me ujë përdoruesit të shumtë dhe do të furnizojë TCKR me ujë për ftohje.

20. ***Si pjesë e përgatitjes së draft VNMS, u krye një studim socio-ekonomik dhe perceptimi me gjithsej 2,052 të anketuar nga zonat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ndikimit të PEK të propozuar, duke përfaqësuar rreth 20 për qind të numrit të përgjithshëm të banorëve në këto hapësira.*** Ndikimet negative sociale në lidhje me aktivitetet përkatëse xehetare janë analizuar në kategoritë e mëposhtme, me rekomandimet për të zbutur ndikimet: (i) shpronësimi i tokave dhe rivendosja e pavullnetshme; (ii) shfrytëzimi i tokave dhe jetesa e bazuar në tokë; (iii) menaxhimi i Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik; (iv) migrimi-brenda; (v) migrimi-jashtë; dhe (vi) shëndeti dhe siguria e komunitetit.

21. ***Ky draft NMS, gjersa paraqet pjesë të rëndësishme e kujdesit të duhur të Bankës për të informuar vendimin eventual për PEK të propozuar, nuk ka qenë, as që ishte menduar të jetë, VNMS përfundimtar për PEK të propozuar.*** Për këtë arsye, ai nuk përfshin plane specifike të menaxhimit, të cilat do të duhej të zhvillohen për centralin e propozuar dhe mihjen përkatëse (p.sh., planet e menaxhimit mjedisor dhe social dhe PVZH për lokacionin specifik). Për këtë arsye, ndërsa draft VNMS për PEK të propozuar rekomandon opsionet e mundshme të zbutjes, në këtë fazë, në mungesë të një projekti të veçantë të investimit të mbështetur nga Banka, Banka nuk mund të sigurojë se Qeveria e Kosovës, dhe/ose ndonjë palë tjetër, përshtatshmërisht, do të zbatojë rekomandimet e tilla.

22. ***Ndryshime të rëndësishme në konfigurimin e TCKR propozuar tani janë duke u diskutuar mes QK dhe investitorit privat.*** Këto ndryshime i kanë bërë disa pjesë të draft VNMS të vjetërsuara. Draft VNMS është i bazuar në një konfiguracion të termocentralit prej 2x300MW dhe në supozimin se Kosova A do të mbyllet. Draft VNMS do të duhet të rishikohet dhe përditësohet në mënyrë të detajuar nga investitori privat i TCKR për të reflektuar ndonjë dizajn të ri të TCKR, veçanërisht në lidhje me teknologjinë e zgjedhur dhe kapacitetin e termocentralit

[5] Në faqe v, Raporti i Hetimit thotë se draft VNMS është financuar përmes një GPRR; por kjo nuk qëndron, pasi që u financua përmes CLRP-SAF.
[6] http://eippcb.jrc.ec.europa.eu/reference/BREF/lcp_bref_0706.pdf.

dhe duke përfshirë masat për zbutje dhe monitorim mjedisor dhe social. Prandaj, draft VNMS mund vetëm të rishikohet, dhe pastaj të shpaloset për konsultim publik,[7] pasi të konfirmohet konfigurimi i TCKR.

23. ***Siç thuhet në Përgjigjen nga Menaxhmenti, nëse Banka vendosë që ta mbështetë PEK të propozuar, mihja që e furnizon TCKR do të konsiderohet si një aktivitet i ndërlidhur.***[8]Kjo do të thotë se Banka do të duhet të bindë veten se të gjitha çështjet relevante mjedisore dhe sociale të TCKR dhe aktiviteteve të ndërlidhura, të cilat përfshijnë mihjen që do të furnizojë TCKR me linjit, janë adresuar siç kërkohet sipas politikave të Bankës, duke përfshirë masat e përshtatshme mbrojtëse. Pasi zhvillimi i mihjes u hoq nga PEK i propozuar, përgjegjësia institucionale për zhvillimin e mihjes dhe zhvendosjen e ndërlidhur, dhe përgatitja e një VNMS të detajuar për planin e zhvillimit të mihjes me masa të veçanta për zbutje dhe monitorim mjedisor dhe social, ka të ngjarë të mbetet te sektori publik, në vend që të bëhet përgjegjësi e investitorit privat, siç është paraparë fillimisht.

24. ***Këto ndryshime të rëndësishme do të duhet të merren parasysh nga Banka***[9] ***kur të marrë vendimin nëse do të mbështesë apo jo TCKR të propozuar.*** Në rast të tillë, Banka do të kërkojë, përveç këtyre, (i) që fonde të mjaftueshme janë në dispozicion për të financuar zhvendosjen e mundshme sipas PEK të propozuar dhe çdo veprimtari të ndërlidhur; (ii) një KPZH të përditësuar që është përgatitur në bazë të mësimeve nga PVSH Shala dhe draft analiza e VNMS dhe planifikimi i përditësuar i mihjes; (iii) planifikimin e zhvendosjes, duke përfshirë përgatitjen e PVZH për fshatrat/lagjet e prekura përkatëse në fushën e mihjes, është kryer mjaftueshëm paraprakisht çfarëdo veprimtarie minerare që prek hapësirat e tilla, bazuar në një plan të përditësuar të zhvillimit të mihjes; dhe (iv) analizën ekonomike të PEK të propozuar që përfshin koston e plotë të aktiviteteve të zhvendosjes.

Zona

25. ***Zona me Interes të Veçantë Ekonomik (Zona)***[10] ***është pjesë e në tërësie më të gjerë të vendimeve të Qeverisë për mihjen në faza të depozitave të linjitit në Fushën e Re të Mihjes dhe nuk ka lidhje me programin e Bankës në Kosovë.*** Zona u krijua me një vendim të Qeverisë në nëntor 2004, dhe rishikuar dhe zgjeruar në vitin 2009. Sipërfaqja e përgjithshme e Zonës, siç deklarohet nga QK, është 143 km$^{2.}$ Shih Hartën 1.

---

[7] Konsultimet publike janë organizuar për Termat e Referencës për VNMS dhe Raportin e fushëveprimit mjedisor dhe social.

[8] Kjo do të jetë sipërfaqja e mihjes që do të jetë e nevojshme për furnizimin e TCKR gjatë gjithë ciklit jetësor të termocentralit, dhe jo e gjithë hapësira e Zonës.

[9] Diskutimet mbi konfigurimin e TCKR të propozuar janë të vazhdueshme. Përveç kësaj, Strategjia e Energjisë për Republikën e Kosovës 2016-2025, e cila ishte dërguar për konsultime në shtator të vitit 2016, ngre çështjen e statusit të Kosovës A. Draft VNMS, i cili bazohet në një konfiguracion 2x300MW për TCKR dhe në mbylljen e Kosovës A, për këtë arsye nuk është shpalosur publikisht deri më sot. Megjithatë, siç u përmend më lart, konsultimet publike janë zhvilluar për draft Termat e Referencës dhe Raporti i fushëveprimit të draft VNMS.

[10] Qeveria e Kosovës ka themeluar Zonën me Interes të Veçantë Ekonomik në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 4/119 nga data 3 nëntor 2004, si pjesë e vendimeve më të gjera të Qeverisë mbi mihjen në faza të depozitave të linjitit në Fushën e Re të Mihjes. Zona me Interes të Veçantë Ekonomik fillimisht ka mbuluar fshatrat Hade, Sibovc, Leshkoshiq dhe Cërkvena Vodicë, dhe Komunën e Obiliqit/Obilić. Qeveria ka rishikuar dhe zgjeruar Zonën për të mbuluar të tërë Fushën e Re të Mihjes në bazë të Vendimit të Qeverisë Nr. 2/57, nga data 13 mars 2009, e cila hyri në fuqi pas miratimit të Planit Hapësinor të Qeverisë nga Kuvendi i Kosovës në tetor të vitit 2011.

26. ***Sfida e Zonës është se ajo cakton për mihje një sipërfaqe të madhe që pritet të mihet për një periudhe të gjatë (të vlerësuar mbi 100 vjet), duke vënë kufizime të ndërtimit për banorët që jetojnë në Zonë.*** Kjo ndikon banorët të cilët nuk do të zhvendosen në të ardhmen e afërt, duke kufizuar mundësinë e tyre për të ndërtuar apo zgjeruar shtëpi. Rrjedhimisht, Zona ka gjithashtu një ndikim në vlerat e pasurive të patundshme për pronarët e tokave në Zonë.

27. ***Draft VNMS vlerëson se sipërfaqja e përgjithshme e nevojshme për një mihje potenciale për të furnizuar TCKR për periudhën deri në vitin 2046[11] do të jetë mes 8 dhe 10 km²·*** Ky vlerësim përfshin një sipërfaqe për largimin e djerrinës, dhe tampon zonën e sigurisë rreth mihjes. Kjo gjithashtu merr parasysh linjitin e nevojshëm për të furnizuar termocentralet aktuale, Kosova B dhe Kosova A deri në mbylljen e tyre.

28. ***Draft VNMS përcakton rekomandimet kryesore për TCKR dhe mihjeve të ndërlidhura, duke përfshirë përmirësimin e menaxhimit të zonës.*** Shumica e këtyre rekomandimeve lidhur me mihjen me gjasë do të mbeten të vlefshme edhe nëse TCKR nuk do të ndërtohet. Për këtë arsye, Banka do t'i diskutojë këto rekomandime në mënyrë më të detajuar me QK, konkretisht rekomandimet për të zbutur ndikimet sociale të mihjes dhe të Zonës.



Harta 1. Vendndodhja e fushave të mihjes, termocentralet, fshatrat e prekura dhe Zona me Interes të Veçantë Ekonomik

[11] TCKR të pritet të arrijë fundin e ciklit të vet jetësor më 2046.

III. KONTEKSTI NË LIDHJE ME VENDIN DHE SEKTORIN

29. ***Furnizimi me energji është një kufizim kyç për zhvillimin ekonomik dhe social në Kosovë.*** Kosova është shteti më i ri i Evropës, pasi fitoi pavarësinë vetëm në vitin 2008 pas konfliktit të zgjatur etnik dhe administrimit ndërkombëtar. Rindërtimi dhe rehabilitimi i sistemit të energjisë, ristrukturimi i qeverisjes së korporatave dhe menaxhimi i shërbimeve të energjisë, KEK, janë parë si sfida prioritare për të mbështetur zhvillimin e vendit. Si një vend sapo i pavarur, përpëlitjet për të fuqizuar institucionet lokale dhe vendimmarrësit kanë ndikuar zhvillimin e kapaciteteve institucionale, institucionet, përfshirë edhe në sektorin e energjisë elektrike. Në një mjedis të pasigurisë së zgjatur dhe rindërtimit pas konfliktit, Banka deshi të ndihmojë Kosovën për të përmirësuar kapacitetin institucional dhe kuadrin ligjor dhe të politikave në sektorin e energjisë, si dhe për të zhvilluar programe të investimeve nëpërmjet një serie të projekteve të investimeve për ndihmesë teknike.

30. ***Angazhimi i Bankës në Sektorin e Energjisë në Kosovë.*** Banka ka qenë një partner i fortë dhe të qëndrueshëm për Kosovën, duke filluar qysh në shtator të vitit 1999, menjëherë pas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që solli fundin e konfliktit dhe bëri thirrje për një përgjigje të shpejtë ndërkombëtare për të mbështetur rindërtimin dhe rimëkëmbjen ekonomike.[12] Në sektorin e energjisë, është arritur një mirëkuptim me donatorët se Banka do të fokusohet në strategjinë afatgjatë për zhvillimin e sektorit (duke plotësuar ndihmën e donatorëve[13] për nevojat e menjëhershme të ngrohjes dhe energjisë elektrike); nevojat afatmesme lidhur me stafin dhe menaxhimin dhe zbutjen mjedisore të të dy termocentraleve dhe mihjeve përkatëse të thëngjillit; dhe rehabilitimi i gjenerimit dhe dispeçimi.[14] Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) i kërkoi Bankës për të ndihmuar në vendosjen e sektorit të energjisë në një rrugë të qëndrueshme.[15] Këto aktivitete janë shtrirë për një periudhë prej pesëmbëdhjetë vjetësh, përmes mbështetjes operacionale, punës ekonomike dhe sektoriale, ndihmesës teknike, dialogut, dhe koordinimit të donatorëve.

31. ***Mjedisi në të cilin Banka ka funksionuar në Kosovë ka qenë shumë i ndërlikuar, me periudha të gjata kohore në të cilat shtresa të shumta të Qeverisë kanë funksionuar në të njëjtën kohë dhe me përgjegjësi të mbivendosura.*** Në vitin 1999, Kosova u vendos nën administrimin e UNMIK. Në vitin 2001, u arrit pajtimi për një Kornizë Kushtetuese, që krijoi Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ). Në kuadër të IPVQ, në dhjetor të vitit 2004 u themelua Ministria e Energjisë dhe Minierave; megjithatë, UNMIK vazhdoi të mbante kompetenca të caktuara dhe autoritet ligjor përfundimtar mbi sektorin. Përveç kësaj, një numër

---

[12] Strategjia për Mbështetje Kalimtare për Kosovën, 16 shtator 1999. Pasi që Kosova nuk ishte anëtare e Grupit të Bankës Botërore, dhe pasi që ish-Jugosllavia pjesë e së cilës ishte Kosova kishte pushuar së qeni anëtare, Banka kishte përdorur të ardhurat e saj neto të vendosura në një fond mirëbesimi për Kosovën të administruar nga IDA për të siguruar ndihma emergjente rehabilitimi për Kosovën.

[13]Raporti i realizimit dhe rezultateve të zbatimit të Projektit të dytë për ndihmesë teknike në sektorin e energjisë, 31 maj 2006.
http://imagebank.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/IW3P/IB/2006/06/15/000090341_20060615093837/Rendered/PDF/35263.pdf

[14] Strategjia për Mbështetje Kalimtare për Kosovën, 16 shtator 1999.

[15]Raporti i realizimit dhe rezultateve të zbatimit të Projektit të dytë për ndihmesë teknike në sektorin e energjisë, 31 maj 2006.

i këshilltarëve të huaj të financuar nga donatorët u vunë në pozita kritike, duke krijuar kështu në mënyrë efektive edhe një shtresë të qeverisjes brenda IPVQ.[16] Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë në mënyrë të njëanshme; më 29 qershor 2009 Kosova iu bashkua Grupit të Bankës Botërore,[17] dhe deri në vitin 2012 prania ndërkombëtare mbikëqyrëse në Kosovë i dha fund rolit të saj mbikëqyrës.[18]

32. Pavarësisht nga këto kompleksitete institucionale, siç vërehet nga Paneli i Inspektimit, *"Banka ka shfaqur qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të shquar"*, dhe ka zhvilluar njohuri të thella dhe marrëdhënie afatgjata në sektorin e energjisë.

33. ***Midis 2001 dhe 2006, tri projekte të investimeve të ndihmesës teknike të financuara nga Banka janë ndërmarrë në sektorin e energjisë.*** Këto projekte investuese kanë mbështetur: (i) një studim gjithëpërfshirës që ka formuar bazën e një strategjie të energjisë dhe programeve të investimeve afatgjata, duke përfshirë alternativat e mundshme të investimeve me koston më të ulët në energji, qymyr, ngrohje qendrore, sektorët e gazit dhe naftës; (ii) studime të fizibilitetit për interkoneksionet rajonale dhe një qendër të kontrollit për të bërë të mundur tregtinë e energjisë me vendet fqinje; (iii) një kornizë ligjore, institucionale dhe të politikave për të tërhequr investimet e sektorit privat në sektorin e energjisë; (iv) dokumentet teknike për t'ia mundësuar sektorit të energjisë të Kosovës për të thelluar integrimin e vet në Komunitetin e Energjisë të Evropës Juglindore në zhvillim e sipër dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë të BE-së; (v) analizën e efikasitetit në shërbimet publike në sektorin e energjisë,[19] programet e reformës së sektorit, dhe një kornizë të tarifave duke përfshirë tarifat nxitëse për burimet e ripërtëritshme të energjisë; dhe (vi) një kornizë të politikave, udhëzimeve, dhe kapaciteteve institucionale për shfrytëzimin e resurseve minerale të Kosovës, duke përfshirë edhe një strategji të sektorit të minierave.[20]

34. Në vitin 2006, Banka ka filluar mbështetjen e IPVQ përmes PATEL për të forcuar kornizën mundësuese të politikave, atë rregullatore, ligjore, mjedisore dhe sociale për të tërhequr investitorët e sektorit privat të klasit botëror për të zhvilluar dhe shfrytëzuar linjitin si resurs kryesor të energjisë në Kosovë për prodhimin e energjisë.[21]

35. Banka aktualisht është duke mbështetur Projektin për efiçiencë të energjisë dhe për energji të ripërtëritshme në Kosovë, i cili është miratuar në vitin 2014. Ky projekt ka për qëllim

---

[16]Raporti i realizimit dhe rezultateve të zbatimit të Projektit për ndihmesë teknike për energji nga linjiti në Kosovë, 31 maj 2006.
http://imagebank.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/IW3P/IB/2012/12/20/000386194_20121220012442/Rendered/PDF/NonAsciiFileName0.pdf

[17] Banka Botërore në Kosovë, 2010.

[18] Profili në BBC - http://www.bbc.com/news/world-europe-18328859

[19]Raporti i realizimit dhe rezultateve të zbatimit të Projektit për ndihmesë teknike në sektorin e energjisë, 11 qershor 2003.
http://imagebank.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/IW3P/IB/2003/06/16/000090341_20030616152021/Rendered/PDF/256451XK1Energy0Sect0TA1ICR.pdf

[20]Raporti i realizimit dhe rezultateve të zbatimit të Projektit të tretë për ndihmesë teknike në sektorin e energjisë, 27 shkurt 2009.
http://imagebank.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/IW3P/IB/2009/07/22/000333038_20090722233723/Rendered/PDF/ICR9540P0888651C0Disclosed071211091.pdf

[21]Raporti i realizimit dhe rezultateve të zbatimit të Projektit për ndihmesë teknike për energji nga linjiti në Kosovë, 10 dhjetor 2012.

për të reduktuar konsumin e energjisë në ndërtesat publike dhe të demonstrojë qëndrueshmërinë ekonomike të investimeve për efiçiencë të energjisë dhe të forcojë kornizën ligjore dhe rregullatore për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme. Ky projekt do të ndihmojë në uljen e kërkesës për energji, duke rritur prodhimin e energjisë nga energjia e ripërtëritshme.

36. Përveç këtyre operacioneve të investimeve të financuara nga Banka, Banka ka mbështetur punën e gjerë ekonomike dhe sektoriale në sektorin e energjisë, duke përfshirë edhe atë në përmirësimin e reformave të subvencioneve të tarifave të energjisë, financimin e efiçiencës së energjisë dhe me një analizë të ndikimit varfëror dhe social.

37. Banka mbetet e angazhuar në diskutimin e mundësive të bëshme për një projekt të gjenerimit të energjisë që siguron furnizim të besueshëm me një çmim të volitshëm me rrezik minimal teknik dhe financiar dhe që është i qëndrueshëm për nga aspekti mjedisor dhe social.[22]

IV. PËRGJIGJA NGA MENAXHMENTI

38. ***Menaxhmenti mirëpret rishikimin e tërësishëm të projekteve nga ana e Panelit.*** Menaxhmenti çmon njohjen e rolit të shquar të Bankës në sektorin e energjisë në Kosovë nga ana e Panelit në një mjedis jashtëzakonisht sfidues me llogaridhënie të paqartë dhe kapacitetet të dobëta institucionale gjatë 15 viteve të fundit. Menaxhmenti i pranon gjetjet e shprehura në Raportin e Panelit dhe paraqet përgjigjen e tij më poshtë dhe, në mënyrë më të detajuar, në Shtojcën 1.

39. ***Menaxhimi pajtohet me gjetjen e Panelit që Banka nuk është përgjegjëse për dëmin që rrjedh nga Zona me Interes të Veçantë Ekonomik.*** Zona u krijua me një vendim të Qeverisë në nëntor 2004 dhe të rishikuar në vitin 2009, dhe kjo nuk ishte e lidhur me ose si rezultat i mbështetjes teknike të Bankës.

40. ***Menaxhmenti gjithashtu pajtohet me gjetjen e Panelit që Banka nuk është përgjegjëse për dëmin që rezulton nga evakuimi emergjent i Hades nga viti 2004/2005.*** Siç është thënë në raportin e Panelit të Inspektimit, vendimi për evakuim është marrë nga UNMIK dhe zhvendosja ishte përgjegjësi e UNMIK, IPVQ, dhe më vonë Qeverisë së Kosovës, pa ndërhyrje nga Banka. Kjo evakuimi nuk ishte rezultat i ose i mbështetur nga çfarëdo projekt investimi të Bankës. Përkundrazi, ai u bë për shkak të kanosjes së ngutshme të rrëshqitjes së tokës që ishte duke rrezikuar disa banorë të fshatit Hade, e cila ishte shkaktuar nga praktikat e dobëta të mihjes dhe blerjes së tokës të trashëguara për një kohë të gjatë kohore.

41. ***Menaxhmenti vëren konstatimin e Panelit se qasja PATEL e përgatitjes së një KPZH dhe më pas duke përgatitur PVZH për çdo lokacion të prekur ishte e përshtatshme dhe në përputhje me OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare.***

42. ***Menaxhmenti i pranon dy rastet e mospajtueshmërisë lidhur me KPZH dhe PVZH të Shalës të përgatitura nën PATEL dhe më pas të monitoruara sipas CLRP-SAF.*** Dy rastet e mospajtueshmërisë të ngritura nga Paneli janë diskutuar në më shumë hollësi më poshtë. Pjesa

[22] PEK i propozuar do të duhet të jenë në përputhje me kriteret për projektet e thëngjillit të përcaktuara në Kornizën strategjike të Grupit të Bankës Botërore për zhvillim dhe ndryshime klimatike.

VII më poshtë përmban planin e veprimit të Menaxhmentit të propozuar për trajtimin e këtyre gjetjeve.

A. Korniza e politikave të zhvendosjes

43. ***Gjetjet e Panelit.*** *Paneli gjen se Menaxhmenti është në mospajtueshmëri pasi nuk e ka aplikuar OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare në përgatitjen e KPZH, dhe në mënyrë specifike nuk ka përfshirë në KPZH parimet dhe metodat për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizimet e Zonës në Fushën e Re të Mihjes.*

44. Menaxhmenti pajtohet se KPZH nuk përmban asnjë metodologji të veçantë për vlerësimin e aseteve të prekura nga kufizimet e Zonës së Veçantë. Megjithatë, KPZH parashtron dhe operacionalizon objektivat, kriteret dhe kërkesat relevante përkatëse, nga OP/BP 4.12 dhe siguron zbatimin e parimit të vlerës zëvendësuese për të siguruar që njerëzit e prekur marrin kompensim të mjaftueshëm për të qenë në gjendje të marrin tokë ose strehim të krahasueshëm diku tjetër, pa marrë parasysh kufizimet që rezultojnë nga Zona. Në pjesën për Parimet e vlerësimit, KPZH thekson se "të gjitha ndërtesat, ndërtesat ndihmëse, gardhet dhe strukturat e tjera, pemët, të lashtat e përhershme dhe përmirësimet duke përfshirë kullotat dhe të lashtat e pa korra/shira, do të vlerësohen me koston e nevojshme për t'i zëvendësuar ato, pa marrë parasysh gjendjen e tyre në kohën e vlerësimit" dhe ndaj vlerësimit të tillë mund të bëhet ankesë nëpërmjet një Komisioni të Pavarur të Ankesave (KPZH f. 17).

45. Menaxhmenti pranon se KPZH duhet përditësuar dhe se ka mangësi të cilat duhet të adresohen për zhvendosjen e ndërlidhur me mihje në të ardhmen. KPZH është përgatitur në vitin 2009, në një kohë kur elementet kryesore institucionale dhe ligjore ishin ende në fluks dhe Ligji për shpronësimin dhe Dekreti për zgjerimin e Zonës ishin në përgatitje e sipër. Këto përgjegjësi institucionale duhet të përditësohen dhe të pasqyrohet në KPZH. Menaxhmenti gjithashtu vë në dukje se Qeveria e Kosovës ka aplikuar KPZH në përgatitjen e zhvendosjes së Shalës, dhe mangësitë e KPZH u trajtuan në PVZH rezultuese.

46. ***Menaxhmenti vëren gjithashtu se kufizimet e vëna në Zonë nuk zbatohen gjithmonë nga Qeveria.*** Është shënuar, për shembull, një shpërthim i ndërtimit në fshatin Shipitullë i cili ndodhet brenda Zonës, dhe i cila - sipas planifikimit të KEK - është fshati i radhës që duhet t'i hapë rrugë operacioneve xehetare. Pavarësisht nga kufizimet e imponuara nga Zona, numri i ndërtesave në Shipitullë u rrit me pothuajse me 75 për qind në mes të 2010 dhe 2015, ndërkohë që numri i banorëve të përhershëm u rrit me më pak se 9 për qind.[23] Menaxhmenti ka kuptuar nga QK se ky është një tregues i aktiviteteve spekulative të ndërtimit në Zonë të cilat thithin sasi të konsiderueshme të të ardhurave familjare.

47. ***Banka do të këshillojë Qeverinë e Kosovës që të përditësojë KPZH, duke marrë në konsideratë faktorët e mësipërm.*** Në mënyrë të veçantë, rekomandimet nga Punëtoria me ekspertët ndërkombëtarë të zhvendosjes e mbajtur në Prishtinë në vitin 2014, mësimet e nxjerra nga Raporti i realizimit për PVZH për Shalën nga korriku i vitit 2016 (Raporti i realizimit) dhe rekomandimet kryesore në lidhje me masat e mundshme zbutëse - duke përfshirë ato nga draft VNMS - për të adresuar ndikimet sociale nga Zona që duhet të merren parasysh. Banka do të

[23] Numri i strukturave në vitin 2010: 173; Numri i strukturave në vitin 2015: 302; Numri i strukturave në vitin 2010: 291; Numri i strukturave në vitin 2015: 317.

organizojë një punëtori me hisetarët kryesorë të Qeverisë për të diskutuar rekomandimet e listuara më sipër. Është e rëndësishme të theksohet edhe një herë se Banka nuk është në pozitë për të siguruar miratimin e rekomandimeve të tilla nga ana e QK në mungesë të një operacioni të investimeve të mbështetur nga Banka, i cili do të kërkonte zbatimin e politikës përkatëse të Bankës.

48. ***Në qoftë se Banka do të vendosë për financimin e PEK të propozuar,*** Banka do të duhet të bind vetveten se të gjitha çështjet relevante mjedisore dhe sociale janë trajtuar siç kërkohet nga politikat e Bankës, duke përfshirë instrumentet e duhura të masave mbrojtëse, të tilla si një KPZH në përputhje me politikën e Bankës.

B. PVZH për Shalën

49. ***Gjetjet e Panelit.*** *Paneli konstaton se Menaxhmenti është në mospajtueshmëri për shkak të mosaplikimit të OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare në përgatitjen e PVZH për Shalën, dhe për dykuptimësinë e PVZH të Shalës në lidhje me rregullimet institucionale dhe mungesën e një plani të detajuar për zhvendosje.*

50. ***Zbatimi i PVZH për Shalën përfundoi në 31 gusht 2016 dhe është dokumentuar në Raportin e realizimit.*** Raporti i realizimit, që daton në korrik 2016, është përgatitur nga një firmë konsulence ndërkombëtare në emër të MMPH dhe është financuar nëpërmjet CLRP-SAF. Raporti i realizimit është shpalosur në Kosovë përmes faqes së internetit të MMPH më 24 gusht 2016 për versionin në gjuhën angleze[24] dhe më 7 shtator 2016 për versionin në gjuhën shqipe.[25] Përveç kësaj, MMPH ka dërguar kopje në letër të Raportit të realizimit në Komunën e Obiliqit, dhe ka postuar njoftimet për disponueshmërisë e raportit në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri. Raporti i realizimit është shpalosur në gjuhën angleze në Imagebank të Bankës Botërore më 20 shtator 2016, dhe në gjuhën shqipe më 26 shtator 2016.[26] Personat e prekur drejtpërdrejt kanë marrë kopje të Raportit të realizimit më 1 tetor 2016.

51. ***Menaxhmenti pranon se ka pasur mangësi në PVZH të Shalës që duhet të shmangen në përgatitjen e PVZH të lidhura me aktivitetet xehetare në të ardhmen në Kosovë.*** Aplikimi i një KPZH të përditësuar dhe rishikuar nga QK do të ndihmojë në adresimin e dobësive të sipërcituara.

52. ***Menaxhmenti pajtohet se ka pasur vonesa në ndërtimin e infrastrukturës bazë në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri sipas PVZH të Shalës.*** Sipas pikëpamjes së Menaxhmentit, këto janë shkaktuar ndjeshëm nga zotësia e dobët e qeverisë për menaxhimin e kontratës ndërtimore. Vonesat kanë vazhduar pavarësisht se Banka e ka ngritur këtë çështje me QK në raste të shumta dhe ka kërkuar përshpejtimin e punimeve. Shembujt kryesor përfshijnë: (i) vonesa në punësimin e të kontraktuarve për infrastrukturën bazë në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri; dhe (ii) progres jashtëzakonisht i ngadalshëm i punimeve të infrastrukturës bazë dhe riparimeve të nevojshme, së bashku me mbikëqyrjen e dobët të ritmit të punës.

---

[24] http://mmph-rks.org/repository/docs/Completion_Report_-_final_269781.pdf
[25] http://mmph-rks.org/repository/docs/Raporti_Final_i_Monitorimit_te_Zhvendosjes_se_Lagjes_Shala_1555.pdf
[26] http://imagebank.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/IW3P/ECA/2016/09/21/090224b08459edcf/2_0/Rendered/PDF/Resettlement0action0plan.pdf
Shqip: http://documents.worldbank.org/curated/en/520071474901190552/Plani-i-veprimit-për-zhvendosje

53. ***Vonesa shtesë kanë ndodhur për shkak të mungesës së marrëveshjes në mes të familjeve të prekura rreth ndarjes së ngastrave në Shkabaj të Ri,*** për shkak të negociatave të zgjatura në mes të 2011 dhe 2013. Nuk është e qartë pse disa familje që kanë zgjedhur një troll në Shkabaj të Ri kanë ndërtuar shtëpitë që nga fundi i vitit 2013, ndërsa të tjerët nuk e kanë bërë këtë. Sipas Raportit të realizimit, ka dëshmi anekdotike se disa familje janë përcaktuar për një troll në Shkabaj të Ri, por më vonë kanë vendosur të shpërngulen ne vende të tjera, të tilla si Prishtina (Raporti i realizimit të PVZH për Shalën f. 11-12).

54. Menaxhmenti pranon se PVZH lidhur me aktivitetet minerare në të ardhmen në Kosovë që përfshijnë zhvendosjen kolektive do të duhet të kenë një orar të detajuar duke vendosur piketa konkrete për procesin, duke përfshirë piketat për njerëzit e prekur për të filluar dhe kryer shtëpitë zëvendësuese brenda një afati të caktuar të arsyeshëm dhe të rënë dakord, si dhe një mekanizëm për angazhim në ndonjë ndryshim në orar duke përfshirë vonesat.

55. ***PVZH për Shalën ka përfshirë objektiva të qarta për kthimin e standardit të jetës. Anketa socio-ekonomike ka gjetur se shumica e njerëzve të zhvendosur nga Shala kanë fituar të ardhurat e tyre nga punësimi i përhershëm ose i përkohshëm, remitancat dhe pensionet, dhe asnjë prej këtyre nuk janë prekur nga zhvendosja.*** Përveç kësaj, asnjë familje nuk ka raportuar të ardhura të fituara nga aktivitetet bujqësore (PVZH për Shalën, f. 30). Në fund, nuk ka pasur raste të identifikuara që kanë kërkuar ndihmë të veçantë të ndërlidhur me të qenit të cenueshëm (Shala RAP, f. 12). Menaxhmenti vëren se Raporti i realizimit ka gjetur se *"Studimi socio-ekonomik i kryer si pjesë e këtij raporti tregon se, në përgjithësi, popullsia e zhvendosur të paktën ka mbajtur në mos përmirësuar kushtet e tyre të jetesës sa i përket kushteve para-zhvendosjes."*

56. ***Sfidat që kanë lindur me zbatimin e PVZH për Shalën, duke përfshirë çështjet e ngritura nga personat e prekur gjatë takimeve të shumta me Bankën, janë identifikuar në raportet e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga ana e Bankës, dhe janë sjellë në vëmendjen e Qeverisë së Kosovës për veprime korrigjuese.*** Një shqetësim që mbetet është riparimi i pakryer i një pjese prej 200 metrash të linjës kryesore të kanalizimeve në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri. Banka do të vazhdojë mbikëqyrjen e CLRP-SAF deri sa kjo çështje të korrigjohet. Sipas MMPH, është angazhuar një i kontraktuar për të riparuar pjesët e sistemit të ujërave të zeza që nuk janë si duke funksionuar si duhet. Kontrata është nënshkruar më 16 shtator 2016 dhe punimet e riparimit pritet të përfundojnë para dhjetorit 2016.

V. PËRGJIGJET PËR VROJTIMET E PANELIT

57. ***Menaxhmenti pajtohet me Panelin se çështjet që lidhen me evakuimin emergjent në 2004/2005 dhe Zonën nuk janë të lidhura me programin e Bankës dhe/ose nuk i nënshtrohen kërkesave të politikave të Bankës.*** Megjithatë, Banka ka ndërmarrë një varg aktivitetesh për të këshilluar Qeverinë e Kosovës për të adresuar çështjet të cilat ndikojnë negativisht qytetarët.

58. ***Menaxhmenti do të donte t'i përgjigjet vrojtimeve të Panelit mbi evakuimin emergjent të Hades në 2004/2005 dhe Zonën, dhe veçanërisht deklaratës se Banka kishte "lëshuar rastet" për të ndihmuar në trajtimin e dëmit. Menaxhmenti është i mendimit se Banka ka përdorur dialogun e saj me QK për të këshilluar mbi dy çështje me interes*** dhe, si thekson

Paneli, Banka ka ndërmarrë ndërhyrje të veçanta për të dyja çështjet, të cilat janë përshkruar në hollësi më poshtë.

Evakuimi emergjent i Hades

59. Evakuimi emergjent 158 familjeve (664 persona) nga fshati Hade është kryer nga UNMIK dhe IPVQ në vitin 2004 dhe 2005. Evakuimi ishte i domosdoshëm për shkak të kanosjes së ngutshme të rrëshqitjes së tokës që ishte duke rrezikuar disa banorë të fshatit Hade, e cila ishte shkaktuar nga praktikat e dobëta të mihjes dhe blerjes së tokës të trashëguara për një kohë të gjatë kohore. Ky evakuim nuk ishte rezultat i ose i mbështetur nga çfarëdo projekt investimi të Bankës, siç theksohet më lart. Gjithsej, 61 familje u zhvendosën përkohësisht në apartamente të siguruara nga qeveria dhe morën shtesa për qira, energji elektrike dhe ushqim. Rreth 30 familje që refuzuan të shpërngulen u evakuuan nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të policisë për shkak të rrezikut të ngutshëm të rrëshqitjes së tokës.

60. Pas një kërkese nga IPVQ, Banka dërgoi një mision prej dy personash në Kosovë në korrik 2004 për të ndarë përvojën e Bankës në zhvendosje dhe të ofrojë këshilla teknike për të trajtuar situatën. Kjo përfshinte ndihmesën në përgatitjen e termave të referencës për konsulentët e zhvendosjes që do të rekrutoheshin nga autoritetet. Ky mision këshillues përbënte një qasje emergjente në përgjigje të rrezikut të pashmangshëm të humbjes së jetëve dhe lëndimit.

61. ***Edhe pse Banka nuk ishte përgjegjëse, ajo ka ndjekur zhvillimet rreth statusit të të evakuuarve të Hades gjatë 2004/2005 dhe inkurajoi Qeverinë e Kosovës që të angazhohet me familjet e prekura, në mënyrë që të zgjidhen çështjet e hapura.*** Informacioni në lidhje me ecurinë e këtij procesi është kërkuar nga Qeveria e Kosovës në baza të rregullta. Sipas Qeverisë së Kosovës, gjendja aktuale është se 98 për qind e familjeve të prekura kanë marrë kompensim, ndërsa pjesa e mbetur prej 2 për qind nuk e kanë pranuar kompensimin dhe në vend të kësaj kanë zgjedhur për ta sfiduar atë në gjykatë, një proces i cili është ende në vazhdim. Nga 158 familje që janë prekur, 98 janë përcaktuar për një troll në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri, dhe 77 prej tyre kanë aplikuar për dhe kanë marrë titullin e pronësisë për trojet e tilla.[27] Infrastruktura publike në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri është siguruar si për njerëzit e prekur nga lagjja e Shalës ashtu edhe për të evakuuarit nga Hadja. Lidhur me çështjet që lidhen me strehimin e përkohshëm ose shtesat për njerëzit e evakuuar në 2004/2005, këto janë konsideruar nga gjykatat vendore dhe kjo nuk do të ishte me Vend që Banka të japë opinion mbi rezultatet pritje.

Zona me Interes të Veçantë Ekonomik

62. ***Adresimi i shqetësimeve në lidhje me Zonën (shih paragrafët 25–28) është një çështje më afatgjatë e cila do të kërkojë veprime dhe përpjekje të niveleve të ndryshme të qeverisjes***, duke përfshirë agjencitë kombëtare, lokale dhe kadastrale. Prandaj, Banka ka kërkuar që ndikimi social i zonës të vlerësohet në draft VNMS.

63. ***Banka ka siguruar ngritjen e kapaciteteve për zhvendosjen, që përfshiu këshilla specifike dhe trajnime relevante për një menaxhim më të mirë të zhvendosjeve të ardhshme në Zonë.*** Kjo ka përfshirë punëtorinë me ekspertët ndërkombëtarë të zhvendosjes të përmendur më parë, dhe një kurs trajnimi për 20 anëtarë të stafit nga MMPH dhe KEK të ofruara nga

[27] Pjesa e mbetur prej 60 janë përcaktuar për kompensim me para të gatshme.

konsulentë të njohur ndërkombëtarisht. Gjithashtu, u zhvillua një vizitë studimore në lokacionet e zhvendosjes së ndërlidhura me veprimtarinë xehetare në Gjermani për të ekspozuar pjesëmarrësit ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare në menaxhimin e zhvendosjeve të ndërlidhura me veprimtarinë minerare. Kjo është përdorur si një pilotim për krijimin e një kursi dyjavor ndërkombëtar praktik të thelluar, duke përfshirë edhe vizita në minierat në Gjermani, me titull "Blerja e tokës, zhvendosja dhe qëndrueshmëria sociale"[28] në partneritet me Universitetin e Groningen (Holandë), konsulentët ndërkombëtar dhe organizata të tjera multilaterale. Ky kurs është ofruar dy herë në vit që nga vera e vitit 2015 dhe deri më sot nga ai kanë përfituar dhjetëra praktikuesve nga e gjithë bota, duke përfshirë 12 nga Kosova.

64. ***Bazuar në këshillën e Bankës, PVZH për Shalën ka paraparë shprehimisht kompensimin për pasuritë e njerëzve të prekur negativisht, duke përfshirë edhe për strukturat ilegale që ata kanë ndërtuar pas vitit 2004 në Zonë.*** Siç u përmend më lart, drafti VNMS për PEK të propozuar identifikon rreziqet dhe ndikimet kryesore mjedisore dhe sociale dhe rekomandon opsione të gjera të zbutjes, të tilla si përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të zhvendosjes në Zonë, të cilat janë të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare në xehetari. Megjithatë, në mungesë të një projekti të veçantë të investimit të mbështetur nga Banka, Banka nuk mund të sigurojë se Qeveria e Kosovës do të zbatojë rekomandimet e tilla.

VI. Plani i Veprimit i Menaxhmentit në përgjigje të gjetjeve

65. Plani i Veprimit i Menaxhmentit për të adresuar gjetjet e Panelit është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

66. Menaxhmenti u takua me Kërkuesit në Kosovë më 5 tetor 2016, me një video link lidhje për stafin në Uashington, për të diskutuar veprimet e propozuara të Menaxhmentit (Plani i Veprimit). Pesë Kërkues morën pjesë në takimin konsultativ, përfshirë përfaqësuesin e Kërkuesve, i cili kishte përzgjedhur pjesëmarrësit e tjerë. Termat dhe lokacionet e takimeve konsultative iu propozuan përfaqësuesit të Kërkuesve më 17 shtator 2016, dhe u dakorduan në bisedat e mëvonshme.

67. Gjatë takimit konsultativ, ekipi i Bankës shpjegoi planin e veprimit të propozuar të Menaxhmentit për t'iu përgjigjur gjetjeve të Raportit të Panelit, dhe kërkoi informacion kthyes nga Kërkuesit për Planin e Veprimit. Kërkuesit pranuan draft veprimet, por edhe propozuan përfshirjen e veprimeve që janë në ashiqare jashtë fushëveprimit të projekteve apo vetë kompetencave të Bankës, të tilla si (i) korrigjimi i ndikimeve të evakuimit emergjent të 2004/2005; dhe (ii) përshpejtimi i zhvendosjes së banorëve të mbetur në Hade.

Çështja	Veprimet e propozuara
1. Mosaplikimi i OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare në përgatitjen e KPZH, dhe në mënyrë	PATEL që ka ofruar mbështetje teknike dhe financiare për përgatitjen e KPZH, u përmbyll në vitin 2011.

[28] http://www.rug.nl/education/summer-winter-schools/winter_schools_2016-2017/land_acquisition/

Çështja	Veprimet e propozuara
specifike mospërfshirja në KPZH e parimeve dhe metodave për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizimet e Zonës në Fushën e Re të Mihjes.	Menaxhmenti pranon se OP 4.12 nuk është identifikuar në Fletën e të dhënave të masave mbrojtëse të integruara për PATEL dhe KPZH për projektin nuk përfshinte një metodologji të veçantë për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizime të Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik. Megjithatë, KPZH është përgatitur nga Qeveria e Kosovës duke marrë parasysh objektivat, kriteret dhe kërkesat e OP/BP 4.12, dhe këto janë paraqitur shprehimisht në KPZH dhe janë operacionalizuar në bazë të pjesëve të ndryshme të saj. Tash e tutje, Banka do të ofrojë këshilla teknike për QK për rishikimin e KPZH me qëllim që të sigurojë konsistencë të plotë të saj me OP 4.12, dhe në mënyrë të veçantë duke përfshirë parimet dhe metodat për vlerësimin e aseteve të atyre që jetojnë në Zonë, deri më 28 shkurt 2017. Këto këshilla do të përfshijnë se si duhet trajtuar dobësitë e tjera të identifikuara dhe si të ndryshohen kushtet, të tilla si: (i) Vlerësimi i popullsisë mundësisht të prekur nga zhvendosja, (ii) Më shumë lidhje ndërmjet KPZH dhe planeve të përditësuara të mihjes; (iii) Udhëzime më të hollësishme për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e duhur, (iv) Analizën e zbrazëtisë në mes të kornizës së re ligjore të Kosovës që është relevante dhe OP 4.12; dhe (v) Përshkrimi i procesit të zbatimit të zhvendosjes, duke përfshirë aranzhimet e punimeve të ndërtimit, aranzhimet financiare dhe masat rezervë. Për më tepër, këshillat teknike do të përfshijnë rekomandimet që u diskutuan me QK gjatë Punëtorisë së ekspertëve ndërkombëtar për zhvendosje në maj të vitit 2014, si dhe rekomandimet e Raportit të realizimit të PVZH të Shalës, dhe analizat e përfshira në draft VNMS për PEK të propozuar. Për të siguruar udhëzime shtesë për QK në lidhje me rishikimin e KPZH, do të organizohet një punëtori me hisetarët kryesorë qeveritarë dhe KEK për t'i diskutuar këto rekomandime në mënyrë më të detajuar, deri më 27 shkurt 2017. Megjithatë, Banka nuk do të jetë në gjendje për të siguruar se këto rekomandime do të miratohen nga Qeveria e Kosovës në mungesë të një operacioni të ndërlidhur të investimeve të financuar nga Banka.
2. Mosaplikimi i OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare në përgatitjen e PVZH për Shalën, dhe	PATEL që ka ofruar mbështetje teknike dhe financiare për përgatitjen e KPZH për lagjen Shala të fshatit Hade, u përmbyll në vitin 2011.

Çështja	Veprimet e propozuara
për dykuptimësinë e PVZH të Shalës në lidhje me rregullimet institucionale dhe mungesën e një plani të detajuar për zhvendosjes.	Edhe pse OP 4.12 nuk është identifikuar në Fletën e të dhënave të masave mbrojtëse të integruara për PATEL, PVZH i Shalës që ishte një komponent i mbështetur në bazë të PATEL është përgatitur nga Qeveria e Kosovës duke marrë parasysh objektivat, kriteret dhe kërkesat e OP/BP 4.12, të cilat janë të përcaktuara shprehimisht në KPZH dhe të operacionalizuara në bazë të pjesëve të ndryshme të saj. Banka pranon vonesat në zbatimin e PVZH të Shalës, por gjithashtu vë në dukje se zbatimi i PVZH të Shalës ka përfunduar, siç dokumentohet në Raportin e realizimit të PVZH të Shalës - me përjashtim të problemit të ujërave të zeza. Pavarësisht që CLRP-SAF është duke u përmbyllur - që ka financuar monitorimin e zbatimit të PVZH të Shalës - Banka do të vazhdojë me mbikëqyrjen e CLRP-SAF derisa të korrigjohen problemet me një pjese të linjës së kanalizimit prej 200 metra në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri. MMPH ka angazhuar një të kontraktuar për të riparuar pjesët e sistemit të ujërave të zeza që nuk janë si duke funksionuar si duhet. Kontrata është nënshkruar më 16 shtator 2016 dhe punimet e riparimit pritet të përfundojnë para dhjetorit 2016.

VII. Konkluzioni

68. Menaxhmenti beson se Banka ka bërë çdo përpjekje për të zbatuar politikat dhe procedurat e saj dhe për të ndjekur misionin e saj në kontekstin e Projektit. Menaxhmenti beson se veprimet e propozuara të përshkruara më sipër i adresojnë gjetjet e Panelit për mospajtueshmëri.

RAPORT DHE REKOMANDIM NGA MENAXHMENTI
NË PËRGJIGJE TË RAPORTIT TË HETIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT PËR PROJEKTIN E PROPOZUAR ENERGJETIK TË KOSOVËS DHE FINANCIMIN E DYTË SHTESË PËR PROJEKTIN PËR PASTRIM TË SEKTORIT TË ENERGJISË DHE BONIFIKIM TË TOKËS

SHTOJCA 1
GJETJET, KOMENTET DHE VEPRIMET

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
1.	**Zonë me interes të veçantë ekonomik** **Paneli gjen se Banka nuk ishte i përfshirë në themelimin e Zonës me interes të veçantë ekonomik në vitin 2004 dhe për këtë arsye nuk është përgjegjëse për dëmin që rrjedh prej saj.** Paneli vëren deklaratën e Menaxhmentit se dy studime të financuara nga Banka kanë shërbyer për të informuar vendimin e Qeverisë për të zgjeruar Zonën në vitin 2009. Paneli beson se madhësia e zonës ku janë aplikuar kufizimet ka tejkaluar në masë të madhe rekomandimet e këtyre studimeve. Paneli tërheq vëmendjen për dëmet serioze dhe kushtet e vështira të përjetuara nga Kërkuesit dhe të tjerët që jetojnë në Zonë, dhe efektet e rënda që vështirësitë e tilla kanë pasur në jetën e tyre për një periudhë të zgjatur kohore. Duke marrë parasysh dëmet e tilla dhe rolin e shquar të Bankës si këshilltare sektori për Qeverinë, Paneli konsideron që mosrekomandimi i zgjidhjeve - të tilla si një reduktim të madh të sipërfaqes së Zonës apo koha dhe metodat e bërjes së vlerësimit - përbëjnë raste të lëshuara nga ana e Bankës për të ndihmuar në trajtimin e dëmit me kohë. Paneli e kupton që Banka do të vlerësojë ndikimin social të Zonës në VNMS për PEK të propozuar. Edhe pse VNMS është vonuar në mënyrë të konsiderueshme, pritet të sugjerojë mjetet e duhura për këto çështje të gjata, të rënda, dhe ende urgjente të trashëgimisë.	**86-102**	**Koment:** ***Menaxhmenti pajtohet me gjetjet e Panelit se Banka nuk ishte e përfshirë në themelimin e Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik dhe nuk është përgjegjëse për dëmin që rrjedh prej saj.*** Menaxhmenti është i vetëdijshëm se Kosova ka dobësi të konsiderueshme me praktikat për shpronësim dhe zhvendosje të ndërlidhura me veprimtarinë xehetare, duke përfshirë ato që lidhen me krijimin dhe menaxhimin e Zonës. Siç thuhet në Përgjigjen e Menaxhmentit Kërkesës për Inspektim (27 korrik 2015), Qeveria e Kosovës, përmes MMPH, ka përgatitur draft VNMS për projektin e propozuar PEK, me financim nga CLRP-SAF. Draft VNMS identifikon rreziqet dhe ndikimet kryesore mjedisore dhe sociale, duke përfshirë zhvendosjen jovullnetare, të krijuara nga aktivitete të ndërlidhura me mihjen e linjitit, dhe rekomandon mundësi të gjera për zbutje, të tilla si përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit të zhvendosjes në Zonë, të cilat janë bazuar në politikat përkatëse të Bankës dhe praktikat e mira ndërkombëtare në industrinë e mihjes. Mirëpo, gjersa draft VNMS për PEK të propozuar rekomandon opsionet e mundshme të zbutjes, në këtë fazë, në mungesë të një projekti të veçantë të investimit të mbështetur nga Banka, Banka nuk mund të sigurojë se Qeveria e Kosovës, dhe/ose ndonjë palë tjetër, do të zbatojë rekomandimet e tilla. Në qoftë se Banka merr vendim të mbështesë PEK të propozuar, Banka do të duhet të bindë veten se të gjitha çështjet relevante mjedisore dhe sociale të TCKR dhe njësive të ndërlidhura, të cilat përfshijnë mihjen sipërfaqësore që do të furnizojë TCKR me linjit, janë adresuar siç kërkohet sipas politikave të Bankës, duke përfshirë masat e përshtatshme mbrojtëse. Menaxhmenti është i mendimit se Banka ka përdorur dialogun e saj me QK për ta këshilluar mbi çështjet me interes, të tilla si Zona, edhe pse - në mungesë të një projekti të investimit të mbështetur nga Banka - politika e Bankës nuk

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
			aplikohet. Gjatë zbatimit të CLRP-SAF, Banka ka siguruar ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme për zhvendosje, me elemente që janë të rëndësishme për menaxhimin e zhvendosje të ardhshme në Zonën, duke përfshirë: Seminarin me ekspertë ndërkombëtarë të zhvendosjes (Prishtinë, 13 maj 2014), trajnimin për 20 pjesëtarë të stafit të MMPH dhe KEK nga ana e konsulentëve të njohur ndërkombëtarisht, dhe një vizitë studimore në lokacionet e zhvendosjes së ndërlidhur me veprimtarinë xehetare në Gjermani (4-9 dhjetor 2014). Kjo vizitë studimore është përdorur si një pilotim për krijimin e një kursi dyjavor ndërkombëtar praktik të thelluar, duke përfshirë vizitat minierave në Gjermani, me titull "Blerja e tokës, zhvendosja dhe qëndrueshmëria sociale" në partneritet me Universitetin e Groningen (Holandë), konsulentët ndërkombëtar dhe organizata të tjera multilaterale. Ky kurs është ofruar dy herë në vit që nga vera e vitit 2015 dhe deri më sot nga ai kanë përfituar dhjetëra praktikuesve nga e gjithë bota, duke përfshirë 12 nga Kosova. **Veprimi:** Nuk kërkohet veprim.
2.	**Evakuimi emergjent i Hades** **Paneli gjen se Banka nuk ishte e përfshirë në evakuimin emergjent të një pjese të fshatit Hade më 2004/05, as ishte e përfshirë në procesin e mëvonshëm të zhvendosjes, dhe kështu nuk është përgjegjëse për dëmin që rrjedh prej saj.** Paneli e kupton se vendimi për evakuim është marrë nga UNMIK dhe zhvendosja ishte përgjegjësi e UNMIK, IPVQ, dhe më vonë Qeverisë së Kosovës. Paneli vrojton se që nga viti 2005 disa misione mbikëqyrëse të Bankës kanë dokumentuar statusin e të evakuuarve dhe kanë propozuar përdorimin e pozitës me ndikim të Bankës, ashtu si bëri Përgjigja e Menaxhmentit, për të gjetur lehtësim për këto familje. Paneli vëren, megjithatë, se përkundër të qenit e vetëdijshme dhe e shqetësuar, Banka nuk ka dhënë asnjë këshillë të veçantë lidhur me zbutjen e situatës. Paneli vëren dëmet serioze që familjet kanë pësuar për shkak të evakuimit emergjent dhe vitet e shumta që ato i kanë kaluar në strehim	**115-133**	***Koment:*** **Menaxhmenti pajtohet me gjetjen e Panelit se Banka nuk ishte e përfshirë në evakuimin emergjent të një pjese të fshatit Hade më 2004/2005, as ishte e përfshirë në procesin e mëvonshëm të zhvendosjes, dhe kështu nuk është përgjegjëse për dëmin që rrjedh prej saj.** Në qoftë se Banka merr vendim të mbështesë PEK të propozuar, Banka do të duhet të bindë veten se të gjitha çështjet relevante mjedisore dhe sociale të TCKR dhe njësive të ndërlidhura, duke përfshirë mihjen sipërfaqësore që do të furnizojë TCKR me linjit, janë adresuar siç kërkohet sipas politikave të Bankës, duke përfshirë masat e përshtatshme mbrojtëse. Sipas pikëpamjes së Menaxhmentit, Banka ka përdorur dialogun e saj me QK për ta këshilluar këtë të fundit mbi çështje të interesit në lidhje me evakuimin emergjent. Edhe pse Banka nuk ishte përgjegjëse, ajo ka ndjekur zhvillimet rreth statusit të të evakuuarve të Hades gjatë 2004/2005 dhe inkurajoi Qeverinë e Kosovës që të angazhohet me familjet e prekura, në mënyrë që të zgjidhen çështjet e hapura. Informacioni në lidhje me progresin është kërkuar nga Qeveria e Kosovës në baza të rregullta. Sipas Qeverisë së Kosovës, gjendja aktuale është se 98 për qind e familjeve të prekura kanë marrë kompensim,

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
	të përkohshme. Paneli ka mësuar se shumica e këtyre familjeve kanë marrë - edhe pse pas vonesave të konsiderueshme - tituj pronësie të trojeve Shkabaj të Ri, duke u ofruar atyre mundësinë për t'u bashkuar me bashkëfshatarët e tjerë nga fshati Hade, nëse kanë interes dhe mjete për ta bërë këtë. Paneli gjithashtu tërheq vëmendjen tek deklarata e Menaxhmentit, në përgjigje të evakuimit emergjent, se VNMS në përgatitje e sipër për PEK të propozuar do të trajtojë mihjen e nevojshme për TCKR si një aktivitet përkatës dhe do të shqyrtojë çështjet relevante.		ndërsa pjesa e mbetur prej 2 për qind nuk e kanë pranuar kompensimin dhe në vend të kësaj kanë zgjedhur për ta sfiduar atë në gjykatë, një proces i cili është ende në vazhdim. Nga 158 familje që janë prekur, 98 janë përcaktuar për një troll në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri, dhe 77 prej tyre kanë aplikuar për dhe kanë marrë titullin e pronësisë për trojet e tilla. Infrastruktura publike në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri është siguruar si për njerëzit e prekur nga lagjja e Shalës ashtu edhe për të evakuuarit nga Hadja. Lidhur me çështjet që lidhen me strehimin e përkohshëm ose shtesat për njerëzit e evakuuar në 2004/2005, këto janë shqyrtuar nga gjykatat vendore dhe nuk do të ishte me vend sikur Banka të jepte opinion lidhur me rezultatet e pritura. Shumica e misioneve mbikëqyrëse të ndërmarra në kuadër të CLRP-SAF kanë ndjekur në vijimësi vonesat e infrastrukturës në Shkabaj të Ri dhe kanë dhënë rekomandime se si të përmirësohet cilësia dhe shpejtësia e përfundimit të infrastrukturës. ***Veprimi:*** Nuk kërkohet veprim.
3. . (a)	**Korniza e politikës së zhvendosjes** **Paneli gjen se qasja e PATEL e përgatitjes së një KPZH dhe më pas duke përgatitur PVZH për çdo lokacion të prekur ishte e duhur dhe në përputhje me OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare.** Kjo është për shkak të natyrës së eksplorimit të minierave, ku vendndodhja dhe afati i saktë për zgjerimin e radhës të minierës nuk mund gjithmonë të përcaktohet vite më parë. Paneli thekson rëndësinë e përgatitjes së një plani të mihjes që lehtëson planifikimin e zhvendosjes të paktën tre vjet para çdo zhvendosjeje të nevojshme.	**143-147**	***Koment:*** **Menaxhmenti pajtohet me gjetjet e Panelit se qasja e përgatitjes së një KPZH dhe më pas duke përgatitur PVZH për çdo lokacion të prekur ishte e përshtatshme dhe në përputhje me OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare.** ***Veprimi:*** Nuk kërkohet veprim.
3. (b)	Paneli gjen se Menaxhmenti është në mospajtueshmëri ngase nuk ka aplikuar OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare në përgatitjen e KPZH, dhe që në mënyrë specifike nuk ka përfshirë në KPZH parimet dhe metodat për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizimet e Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik. Paneli vëren se KPZH ka ndikime të rëndësishme sociale në popullsinë që jeton në Fushën e Re të Mihjes. Pajtueshmëria me OP/BP 4.12 ishte e nevojshme për të siguruar	**148-157**	***Koment:*** **Menaxhmenti pranon se OP 4.12 nuk u shkrep për PATEL ashtu siç kërkohet, mirëpo, OP/BP 4.12 megjithatë është aplikuar në zhvillimin e KPZH.** Edhe pse OP 4.12 nuk është identifikuar në Fletën e të dhënave të masave mbrojtëse të integruara për PATEL, KPZH i Shalës që ishte një komponent i mbështetur në bazë të PATEL është përgatitur nga Qeveria e Kosovës duke marrë parasysh objektivat, kriteret dhe kërkesat e OP/BP 4.12, të cilat janë të përcaktuara shprehimisht në KPZH dhe të operacionalizuara në bazë të pjesëve të ndryshme të saj.

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
	identifikimin dhe zbutjen e duhur të ndikimeve negative. Paneli njeh zotimin nga Përgjigja për të përditësuar KPZH bazuar në mangësitë e identifikuara dhe për të reflektuar kushtet e ndryshuara. Paneli pret që KPZH e përditësuar, e propozuar, do të shqyrtojë ndikimet e zhvendosjes në kontekstin e kufizimeve të Zonës.		**Menaxhmenti tutje vë në dukje se KPZH u aplikua nga Qeveria e Kosovës për PVZH të Shalës, dhe mangësitë u trajtuan në PVZH rezultuese. Tash e tutje, Banka do të këshillojë Qeverinë e Kosovës për nevojën për të rishikuar dhe përditësuar KPZH.** ***Menaxhmenti pranon se në KPZH mungon përshkrimi i metodave të veçanta për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizimet e Zonës. Megjithatë, KPZH kërkon në mënyrë të qartë zbatimin e parimit të "vlerës së zëvendësimit", sipas OP/BP 4.12.*** Në lidhje me *"parimet dhe metodat për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizimet e Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik"*, Menaxhmenti vëren se gjersa nuk ka metoda të veçanta për vlerësimin e aseteve të prekura nga kufizimet në Zonë, KPZH kërkon zbatimin e parimit të "vlerës së zëvendësimit", sipas OP/BP 4.12, dhe në pjesën "Parimet e vlerësimit" thotë se *"të gjitha ndërtesat, ndërtesat ndihmëse, gardhet dhe strukturat e tjera, pemët, të lashtat e përhershme dhe përmirësimet duke përfshirë kullotat dhe të lashtat e pa korra/shira, do të vlerësohen me koston e nevojshme për t'i zëvendësuar ato, pa marrë parasysh gjendjen e tyre në kohën e vlerësimit"* dhe ndaj vlerësimit të tillë mund të bëhet ankesë nëpërmjet një Komisioni të Pavarur të Ankesave (KPZH f. 17). Kjo do të thotë se personat e prekur, pavarësisht ndikimit nga Zona, duhet të marrin kompensim të mjaftueshëm për të qenë në gjendje për të marrë tokë apo strehim me karakteristika të ngjashme në vende të tjera. ***Megjithatë, siç thuhet në Përgjigjen në Kërkesën për Inspektim, KPZH duhet të përditësohet në çdo rast, për të adresuar dobësitë e identifikuara nga Paneli, si dhe për të reflektuar ndryshimet në kuadrin ligjor të vendit. Përditësimi i KPZH duhet të përfshijë metodat për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizimet e Zonës dhe duke u bazuar në mësimet e nxjerra nga zbatimi i PVZH të Shalës, të identifikuar në***

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
			Raportin e realizimit, si dhe rekomandimet nga draft VNMS për PEK të propozuar. Disa rekomandime në këtë drejtim janë ndarë tashmë me QK gjatë Punëtorisë me ekspertët ndërkombëtarë të zhvendosjes të organizuar nga Banka në Prishtinë në maj të vitit 2014. Pjesëmarrësit kanë përfunduar se shumë aspekte të KPZH dhe PVZH për Shalën janë duke funksionuar siç duhet, por disa aspekte duhet të rishikohen për zhvendosjet në të ardhmen, duke përfshirë çështje që kanë të bëjnë me jetesën që bazohet në bujqësi, shmangien e zhvendosjes së përkohshme, kriteret për shtesat për qira, dhe përgjegjësitë për infrastrukturën dhe shërbimet në lokacionin e zhvendosjes. ***Veprimi:*** **Banka do të ofrojë këshilla teknike për QK për rishikimin e KPZH me qëllim që të sigurojë konsistencën e saj me OP 4.12, dhe në mënyrë të veçantë të përfshijë parimet dhe metodat për vlerësimin e aseteve të atyre që jetojnë në Zonë, deri më 28 shkurt 2017.** Kjo këshillë do të përfshijë atë se si duhen trajtuar çështjet e mëposhtme: (i) Vlerësimi i popullsisë mundësisht të prekur nga zhvendosja, (ii) Më shumë lidhje ndërmjet KPZH dhe planeve të përditësuara të mihjes; (iii) Udhëzime më të hollësishme për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e duhur, (iv) Analizën e zbrazëtisë në mes të kornizës së re ligjore të Kosovës që është relevante dhe OP 4.12; dhe (v) Përshkrimi i procesit të zbatimit të zhvendosjes, duke përfshirë aranzhimet e punimeve të ndërtimit, aranzhimet financiare dhe masat rezervë. Për më tepër, këshillat teknike do të përfshijnë rekomandimet që u diskutuan me QK gjatë Punëtorisë së ekspertëve ndërkombëtar për zhvendosje në maj të vitit 2014, si dhe rekomandimet e Raportit të realizimit të PVZH të Shalës, dhe analizat e përfshira në draft VNMS për PEK të propozuar. Për të siguruar udhëzime shtesë për QK në lidhje me rishikimin e KPZH, do të organizohet një punëtori me hisetarët kryesorë qeveritarë dhe

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
			KEK për t'i diskutuar këto rekomandime në mënyrë më të detajuar, deri më 27 shkurt 2017. Megjithatë, Banka nuk do të jetë në gjendje për të siguruar se këto rekomandime do të miratohen nga Qeveria e Kosovës në mungesë të një operacioni të ndërlidhur të investimeve të financuar nga Banka.
4. (a)	**Zhvendosja e Shalës** Paneli konstaton se Menaxhmenti është në mospajtueshmëri për shkak të mosaplikimit të OP/BP 4.12 dhe për dykuptimësinë e PVZH për Shalën në lidhje me rregullimet institucionale dhe mungesën e një plani të detajuar për zhvendosjes. Paneli beson se këto lëshime kanë kontribuar në vonesat e konsiderueshme të përjetuara gjatë kësaj zhvendosjeje. Anëtarët e komunitetit kanë mbetur në status të përkohshëm për një periudhë të zgjatur që ka shkaktuar dëm duke tej zgjatur pasigurinë për të ardhmen e tyre dhe shkëputjen në jetën e tyre. Paneli gjithashtu thekson si një mangësi të PVZH për Shalën mosvëmendjen e kushtuar për strategjitë e jetesës për të gjitha familjet e prekura, duke përfshirë edhe më të prekshmit dhe më të varfrit, sidomos duke pasur parasysh që ky PVZH është menduar si një model për zhvendosjen e ardhshme në Fushën e Re të Mihjes. Paneli vëren se Programi për kthimin e standardit të jetës dhe zhvillimin e komunitetit i paraparë në PVZH nuk është zhvilluar, dhe vë në dukje rëndësinë e rekomandimit të Raportit përfundimtar të realizimit që mundësitë e punësimit të plotësohen me aktivitete të tjera mbështetëse për jetesën në rastet e ardhshme të zhvendosjes.	**171-184**	***Koment.*** **Menaxhmenti i pranon të metat në PVZH të Shalës.** Ashtu si me diskutimin lidhur me KPZH nën pikën 3b më sipër, Menaxhmenti dëshiron të përsërisë se, edhe pse OP 4.12 nuk është identifikuar në Fletën e të dhënave për masat mbrojtëse të integruara për PATEL, siç thuhet në Përgjigjen nga Menaxhmenti, PVZH e Shalës është përgatitur në bazë të objektivave, kritereve dhe kërkesave në OP/BP 4.12, të cilat janë deklaruar shprehimisht në PVZH dhe operacionalizuar në bazë të pjesëve të ndryshme të saj. Menaxhmenti pajtohet se ka pasur vonesa në ndërtimin e infrastrukturës bazë në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri sipas PVZH të Shalës. Sipas pikëpamjes së Menaxhmentit, këto janë shkaktuar ndjeshëm nga zotësia e dobët e qeverisë për menaxhimin e kontratës ndërtimore. Për më tepër, u desh më shumë se një vit që anëtarët e komunitetit të merren vesh mes vete për ndarjen e ngastrave brenda lokacionit të zhvendosjes në Shkabaj të Ri. Menaxhmenti gjithashtu do të donte të theksojë se 52 familjet që u përcaktuan për një troll Shkabaj të Ri kanë marrë titullin e pronësisë dhe 48 kanë kërkuar dhe kanë marrë lejet e ndërtimit. Infrastruktura themelore është vërtetuar të jetë e plotë për ndërtimin e shtëpive në dhjetor 2013, dhe disa familje kishin filluar tashmë ndërtimin asokohe. Lidhja e tubacioneve të ujërave të zeza me sistemin kryesor të ujërave të zeza ishte gati deri në prill të vitit 2014[29]. Megjithatë, që nga korriku 2016, vetëm 15 shtëpi ishin të gatshme për banim në vendin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri, nga të cilat 12 janë banuar. Menaxhmenti pranon se PVZH lidhur me aktivitetet minerare në të ardhmen në Kosovë që përfshijnë zhvendosjet kolektive do të duhet të kenë një orar të detajuar duke vendosur piketa konkrete për procesin, duke përfshirë piketat për

[29] Më pas, ndodhi kullimi i bllokuar i tubacioneve të kanalizimit duke prekur tri shtëpi, që u riparua dhe edhe një pjesë e gypave të ujërave të zeza e shtrirë përgjatë 200 metrave është duke u riparuar aktualisht.

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
			njerëzit e prekur për të filluar dhe kryer shtëpitë zëvendësuese brenda një afati kohor të caktuar të arsyeshëm dhe të rënë dakord. Për sa i përket kthimit të standardit të jetës, PVZH e Shalës përmban objektiva të qarta për kthim të standardit të jetës. Ai po ashtu ka përfshirë edhe anketën socio-ekonomike që ka gjetur se njerëzit e zhvendosur nga Shala kanë fituar të ardhurat e tyre nga punësimi i përhershëm ose i përkohshëm, remitancat dhe pensionet, dhe asnjë prej këtyre nuk janë prekur nga zhvendosja. Në rastin e PVZH për Shalën, asnjë familje nuk ka raportuar të ardhura të fituara nga aktivitetet bujqësore (PVZH për Shalën, f. 30). Duke pasur parasysh se jetesa nuk ka qenë e bazuar në tokë, nuk u kërkua asnjë aktivitet shtesë për kthim të standardit të jetesës. Në fund, nuk ka pasur raste të identifikuara që kanë kërkuar ndihmë të veçantë të ndërlidhur me të qenit të cenueshëm (Shala RAP, f. 12). Për çdo rast, si pjesë e një mase për kthim të standardit të jetesës të dakorduar me familjet e prekura, KEK ka siguruar 20 vende pune me orar të plotë për këta njerëz. Kohët e fundit, Raporti i realizimit të PVZH të Shalës (27 korrik 2016), i kryer nga një firmë konsulence ndërkombëtare për zhvendosje në emër të MMPH dhe financuar në kuadër të CLRP-SAF, gjeti se kompensimi në të holla dhe ngastrat e tokës janë dhënë sipas PVZH dhe se *"Studimi socio-ekonomik i kryer si pjesë e këtij raporti tregon se, në përgjithësi, popullsia e zhvendosur të paktën ka mbajtur në mos përmirësuar kushtet e tyre të jetesës sa i përket kushteve para-zhvendosjes.*[30] *Veçanërisht në lidhje me familjet të cilat janë zhvendosur fizikisht dhe tashmë janë shpërngulur në Shkabaj të Ri, ka prova të qarta për përmirësimin e qasjes në shërbimet publike dhe infrastrukturë më të mirë që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës.* ***Për më tepër, popullsia e përgjithshme, e zhvendosur fizikisht dhe ekonomikisht, tregon shkallë më të lartë të punësimit dhe përmirësim të kushteve të jetesës në krahasim me vitin 2011.*** *Informacionet e hulumtimit tregojnë se një pjesë më e madhe e popullsisë tani ka ngastra të mëdha të tokës për banim, ku ata mund të kryejnë aktivitete komplementare bujqësore për*

[30] Gjetjet e Raportit të realizimit janë të bazuara në një studim të rreth 40% të familjeve të prekura.

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
			konsumin e tyre (p.sh., kopshte perimesh) në krahasim me vitin 2011. Vizitat në terren kanë konfirmuar gjithashtu se familjet që tani jetojnë në Shkabaj të Ri janë duke mbjellë të lashta në ngastrat e tyre të tokës së banimit. (...) Në përfundim, ne gjejmë se jetesa dhe kushtet e jetës të paktën janë kthyer dhe në disa raste janë përmirësuar për AP [njerëzit e prekur]". (f. 36-37) Nuk ka veprime të mëtejshme në lidhje me kthimin e standardit të jetesës që janë identifikuar në Raportin e realizimit për ata që janë mbuluar nën PVZH për Shalën. Menaxhmenti vëren se rekomandimi nga Raporti i realizimit të PVZH për Shalën i cituar në Raportin e Panelit se "mundësitë e punësimit duhet të plotësohen me aktivitete të tjera mbështetëse të jetesës," i referohet zhvendosjeve në të ardhmen, jo vetë zhvendosjes së Shalës dhe është një nga rekomandimet e shumta për zhvendosjet në të ardhmen nxjerrë nga përvoja me PVZH për Shalës që janë të përfshira në raportin e realizimit. ***Veprimet:*** Raporti i realizimit për PVZH për Shalën nga data 27 korrik 2016 tregon se vazhdon të ketë probleme me funksionimin e një pjese prej 200 metrash të sistemit të ujërave të zeza në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri. Banka do të vazhdojë mbikëqyrjen e CLRP-SAF derisa të korrigjohen problemet me këtë pjesë të linjës së kanalizimit në lokacionin e zhvendosjes në Shkabaj të Ri. MMPH ka angazhuar një të kontraktuar për të riparuar pjesët e sistemit të ujërave të zeza që nuk janë si duke funksionuar si duhet. Kontrata është nënshkruar më 16 shtator 2016 dhe punimet e riparimit pritet të përfundojnë para dhjetorit 2016.
4. (b)	**Paneli gjen se monitorimi dhe mbikëqyrja pas ri-angazhimit të Bankës në procesin e zhvendosjes sipas CLRP-SAF është në përputhje me OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare.** Paneli vëren vonesat e konsiderueshme në përgatitjen e lokacionit të zhvendosjes dhe dëmin që këto kanë shkaktuar në komunitetin	**185-195**	***Koment:*** **Menaxhmenti pranon se mbikëqyrja e CLRP-SAF e procesit të zhvendosjes ishte në përputhje me OP/BP 4.12.** Menaxhimi pajtohet se: (i) ka pasur vonesa të konsiderueshme në përgatitjen e lokacionit për zhvendosje, por ato nuk ishin shkaktuar nga PVZH për Shalën apo nga mosveprimi i Bankës; (ii) financimi i cili u bë në dispozicion nën CLRP-

Nr.	Gjetjet e Panelit	Ref Para	Komenti/Veprimi
	e prekur, duke përfshirë qëndrimin e tyre të zgjatur në strehim të përkohshëm. Duke pasur parasysh kufizimet e kapacitetit të agjencisë zbatuese dhe Huamarrësit, vonesat e gjata në kontraktimin e një firme për ta monitoruar zbatimin e PVZH për Shalën mund ta kenë kompromentuar aftësinë e Bankës për t'i rekomanduar zgjidhje Qeverisë në fazë kritike. Monitorimi i mëhershëm do të kishte ndihmuar në shkurtimin e vonesave dhe do të kishte mbështetur punën thelbësore në programet për përmirësim të jetesës, zhvillimin e komunitetit dhe trajtimin e ankesave gjatë fillimit të procesit të zhvendosjes.		SAF për të monitoruar zbatimin e PVZH për Shalën dhe mbikëqyrja përkatëse nga Banka ka përmirësuar procesin e zhvendosjes; dhe (iii) monitorimi i mëhershëm mund të kishte qenë i dobishëm për të zvogëluar vonesat në përgatitjen e lokacionit të zhvendosjes. ***Veprimi:*** Nuk kërkohet veprim.

SHTOJCA 2
GJETJET E PANELIT

Çështja	Gjetjet e Panelit
1: Zonë me interes të veçantë ekonomik	Paneli gjen se Banka nuk ishte i përfshirë në themelimin e Zonës me interes të veçantë ekonomik në vitin 2004 dhe për këtë arsye nuk është përgjegjëse për dëmin që rrjedh prej saj.
2: Evakuimi emergjent i Hades	Paneli gjen se Banka nuk ishte e përfshirë në evakuimin emergjent të një pjese të fshatit Hade më 2004/2005, as ishte e përfshirë në procesin e mëvonshëm të zhvendosjes, dhe kështu nuk është përgjegjëse për dëmin që rrjedh prej saj. Paneli e kupton se vendimi për evakuim është marrë nga UNMIK dhe zhvendosja ishte përgjegjësi e UNMIK, IPVQ, dhe më vonë Qeverisë së Kosovës.
3: Korniza e politikave të zhvendosjes	Paneli gjen se qasja e PATEL e përgatitjes së një KPZH dhe më pas duke përgatitur PVZH për çdo lokacion të prekur është e duhur dhe në pajtim me OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare.
	Paneli gjen se Menaxhmenti është në mospajtueshmëri ngase nuk ka aplikuar OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare në përgatitjen e KPZH, dhe që në mënyrë specifike nuk ka përfshirë në KPZH parimet dhe metodat për vlerësimin e pasurive të njerëzve të prekur që jetojnë nën kufizimet e Zonës me Interes të Veçantë Ekonomik.
4. Zhvendosja e Shalës	Paneli konstaton se Menaxhmenti është në mospajtueshmëri për shkak të mosaplikimit të OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare në përgatitjen e PVZH për Shalën, dhe për dykuptimësinë e PVZH të Shalës në lidhje me rregullimet institucionale dhe mungesën e një plani të detajuar për zhvendosje.
	Paneli gjen se monitorimi dhe mbikëqyrja pas ri-angazhimit të Bankës në procesin e zhvendosjes sipas CLRP-SAF është në pajtim me OP/BP 4.12 për Zhvendosjen Jovullnetare.

Ky dokument është përkthim i cili është ofruar si shërbim për palët e interesuara. Nëse ndonjë pjesë e tekstit të dokumentit origjinal në anglisht është në kundërshtim me tekstin e këtij përkthimi, dokumenti origjinal në gjuhën angleze ka përparësi.